



REPUBLIKA E SHQIPERISE
KESHILLI KOMBETAR I UJIT
KESHILLI I BASENIT UJEMBLEDHES I LUMIT MAT

V E N D I M

Nr.08 Date 21/04/2011

**"Per dhenien me Koncesion te burimit ujore
per prodhim te energjise elektrike, nepermjet ndertimit te
Hidrocentraleve ne "Slikalle-Cerruje", ne "Klos" - Mat,
Shoqerise koncesionare "Energy Partners Al" shpk.**

Bazuar ne ligjin nr. 8093 dt. 21.03.1996 " Per rezervat ujore", neni 18 germa dh, Ligjet: nr.9663 dt. 18.12.2006 "Per Koncesionet" (i ndryshuar) dhe te vendimit nr. 87 dt.16.01.2008 te K.M., "Per disa ndryshime dhe shtesa ne vendimin nr.27 dt. 19.01.2007 te K.M. " Per miratimin e rregullave te vleresimit dhe te dhenies se Koncesioneve", te ndryshuar, ne Kreun XL piken 9." Shpallja e fituesit dhe negocimi i kontrates", te Vendimit te K.K.U-it, nr.3 dt. 19.07.2002 "Per miratimin e rregullores te K.K.U-se, te K.B.U-se dhe A.U-it", te Vendimit te K.M, nr. 1484, dt 12.11.2008, " Per nje shtese ne vendimin nr. 23, dt.09.01.2008 te K.M, Per tarifat e perdorimit te ujit" dhe kontrates se koncesionit Nr. 1056 Rep Nr. 809 Kol, date 31.08.2009, si dhe te V.K.M. nr. 37 dt. 14.01.2009, me propozim te A.U.B. Mat, **Keshilli i Basenit Mat,**

V e n d o s i:

1. MIRATIMIN e Lejes per Perdorim te Rezervave Ujore te burimit ujore te pellgut ujembledhes te perroit te Benjtit, shoqerise koncesionare "Energy Partners Al" sh.p.k per prodhimi te energjise elektrike, nepermjet ndertimit te Hidrocentraleve ne Slikalle-Cerruje", ne Klos-Mat.

Tabela me treguesit e skemes se shfrytezimit te ujit:


Hec-i	Z	N	E	Emri i rrjedhes ujore ku eshte VM.	Kuota	Prurja llogaritese
	(m)	(kW)	GWh/vit		m.m.n.d	(m3/sek)
Shkalla	295.7	1300	4.32	Prr. Bargjajve	1550	0.4
				Prr.Valit	1550	0.4
Cerruja 1 dhe 2	581.9	5100	17.33	Prr.Bargjajve	1245	0.6
				Prr.Valit	1245	0.6
Rrype	202	3600	11.5	Prr.Paleshes	645	1.5
				Prr.Rrypes	645	0.8
Klos	136.5	2670	8.56	Prr.Rrypes	435	0.5
				Prr.Moles	435	0.5

2- Ngarkohet AUB Mat per zbatimin e ketij vendimi dhe lidhje te kontrates me subjektin "Energy Partners Al", administrator zoti **Z. Sokol Meqemeja.**

3. Ky vendim hyn ne fuqi menjehere.

PERGJEGJESI I A.U.B. MAT

Pashk NDOCI



KRYETARI I K.B.U. MAT

Pal DAJCI

